



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIĆ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. X-425  
Br.

Data 16.07.2020  
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ



### DREJTORIA PËR ARSIM

|                       |   |
|-----------------------|---|
| Datë/Data/Date:       | 16/07/2020                                    |
| Për/Za/To:            | z.Burim Gërguri – Kryesues i Kuvendit Komunal |
| Nga/Od/From:          | Rexhep Zeka – Drejtor                         |
| Tema/Subjekat/Subject | Kërkesë                                       |



Drejtoria për Arsim ka planifikuar të bëjë plotësim ndyrshimin e Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore me Nr.I-149 datë 30/08/2019, andaj kërkojmë nga ju që të iniconi procedurat ligjore për plotësim ndryshim të rregullores së lartcekur.

Me respekt.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration  
 Ministry of Local Government Administration

No. 0-966/1  
 Data 13.09.2019



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
 Ministry of Local Government Administration

|                      |  |                                |
|----------------------|--|--------------------------------|
| Për:                 | Ekrem Kastrati, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit  |                                |
| Kopje:               | Kryetari i Komunës së Obiliqit<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL   |                                |
| Përmes:              | Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL  |                                |
| Nga:                 | Besim Myrtezani, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave  | Datë: 11/09/2019<br>Nr.020-966 |
| Zyrtarët përgjegjës: | 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor<br>Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave |                                |
| Lënda:               | Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Obiliqit  |                                |
| Lloji i aktit:       | Vendim i Kuvendit të Komunës   |                                |

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr.149, për aprovimin e Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Obiliqit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendim Nr.149, për aprovimin e Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore  
 I miratuar më datë: 30.08.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.09.2019



-1-119

2028 2019

Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.031-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3 të Statutit të Komunës si dhe në përputhje me Statutin e Kuvendit, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.30.8.2019, mënyrën e mëposhtme:

## V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Ti dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- MAPL
- DKA
- Anëtarëve të KK
- Arkivit


Kryesuesi i Kuvendit Komunal

*[Signature]*  
Dimitri Zariq

- 1 - 1149 30.08.2019



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Obiliqit  
Opština-Obiliq  
Municipality of Obiliq

**RREGULLORE PËR NDARIEN E BURSIVE, KOMPENSIMIN E  
SIPENZIMIT VE TË UDHËTIMIT DHE AKTIVITETEVE JANHËSHKOLLORE**

Obiliq, 2019

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12.2, nën pikën (c), nenit 17 pika (s) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nr.28/2008, nenit 15 pika 5.1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar nr.04L/032, dhe nenit 81 të Statutit të Komunës së Obiliqit nr.-1-34 të dt.25/04/2016, Kuvendi i Komunës së Obiliqit, në mbledhjen e mbajtur më 30-08-2019, miratoi:

## RREGULLOREN PËR NDARJEN E BURSAVE, KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE TË UDHËTIMIT DHE AKTIVITETEVE JASHTËSHKOLLORE

### 1.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Qëllimi

Në këtë Rregullore, përcaktohen procedurat, kushtet, kriteret për ndarjen e bursave, kohëzgjatja e realizimit të bursës, për nxënës të shkollave të mesme të larta, studentët e të tri niveleve në studime akademike, të studimeve themelore, studime në nivelin master dhe doktoraturës, si dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas, dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

#### Neni 2 Ndarja e bursave

Komuna e Obiliqit, varësisht prej mjeteve financiare që ka në dispozicion, ndanë bursa për nxënës dhe studentë të Komunës së Obiliqit, që mësimet përkatësisht studimet i vijonë në bartësit publik të arsimit parauniversitar dhe universitar në Republikën e Kosovës.

#### Neni 3 Shuma financiare

Kryetari i Komunës merr vendimin, për lartësinë financiare për bursa që ndahen për një vit shkollor, përkatësisht akademik.

#### Neni 4 Kohëzgjatja e bursës

Bursa ndahet vetëm për vitin shkollor, përkatësisht akademik, për të cilin publikuar konkursi.

## Neni 5 Formimi i komisioneve

Komisionet për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, dhe aktivitetet jashtëshkollore e formon Kryetari i Komunës, kurse komisionin për ankesa e formon Kuvendi i Komunës për çdo vit shkollor, përkatësisht akademik. Komisionet do të jenë të përziera (anëtar të kuvendit dhe nga administrata)

## Neni 6 Shpallja e konkurseve

1. Konkursët shpallen nga Drejtoria e Arsimit (DA) në ueb -faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve.
2. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, për bursa, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktivitetet jashtëshkollore.
3. Drejtoria e Arsimit është e obliguar t'i kryejë të gjitha punët tekniko-administrative të domosdoshme dhe të nevojshme gjatë tërë procesit.

## Neni 7 Kushtet për ndarjen e bursave

1. Të drejtë për bursë komunale kanë studentët dhe nxënësit, të cilët i plotësojnë këto kushte:
  - 1.1 Të jenë banorë të Komunës së Obiliqit.
  - 1.2 Të jenë të regjistruar si nxënës, përkatësisht studentë të rregullt, për herë të parë në vitin shkollor, gjegjësisht akademik, për të cilin ndahet bursa.

## Neni 8 Kushtet dhe kriteret për të fituar bursë për studentë

1. Kushtet dhe kriteret për të fituar bursën për studentë janë:
  - 1.1 Niveli i studimeve themelore (bachelor).
    - a. Të jenë studentë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve, përjashtim bëjnë studentët me aftësi të kufizuara dhe studentët fëmijë të dëshmorëve, të cilët përfitojnë bursë edhe për vitin e parë të studimeve, si studentë të rregullt.
    - b. Të kenë të regjistruar për herë të parë vitin (gjegjësisht semestrin e vitit) për të cilin ndahet bursa.

- c. Kategorite e dala nga lufta e UÇK-së
- d. Rastet sociale

1.2. Niveli i studimeve master drojtimet:

- a. Fakulteti i Shkencave Matematiko- Natyrore, Departamenti i Matematikës, përkatësisht Fizikës, Fakulteti i Edukimit
- b. Fakulteti Teknik
- c. Specializime në lëmin e mjekësisë.

1.3 Niveli i doktoraturës

Nga të gjitha lëmitë e shkencave

**Neni 9.**  
**Lartësia e bursës**

Lartësia e bursës do të shkallëzohet në 5 (pesë) kategori për :

- a. Studentët fëmijë të dëshmorëve dhe familjeve , të cilat janë raste sociale në aspektin ekonomik-financiar, viti i parë, kategori e parë
- b. Studentët e vitit të dytë, me notë mesatare gjerë në 8-të, kategori e parë.
- c. Studentët e vitit të dytë, me notë mesatare, 8-të e më tepër, kategori e dytë.
- d. Studentët e vitit të tretë, me notë mesatare gjerë në 8-të, kategori e dytë.
- e. Studentët e vitit të tretë, me notë mesatare, 8-të e më tepër, kategori e tretë.
- f. Studentët e vitit të katërt, me notë mesatare gjerë në 8-të, kategori e tretë.
- g. Studentët e vitit të katërt, me notë mesatare, 8-të e më tepër, kategori e katërt.
- h. Studentët e vitit të pestë, me notë mesatare gjerë në 8-të, kategori e katërt.
- i. Studentët e vitit të pestë, me notë mesatare, 8-të e më tepër, kategori e pestë.

**Neni 10**  
**Bonuset**

1. Studentët e këtyre kategorive kanë bonus shtesë, prej 0.5 (gjysëm pikë) më tepër, në aspektin e notës mesatare, notë mesatare që e përcakton kategorinë e studentit për bursë, sipas nenit 9 të kësaj Rregulloreje si:

1.2 Rastet sociale, gjendja e tyre ekonomike financiare .

1.3 Studentët e veteranëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së .

1.4 Studentët, prindërit e të cilëve kanë qenë të burgosur politik .

1.5 Studentët nga komunitetet pakicë.

1.6 Studentët që nuk e kanë së paku njërin prind, apo nuk jetojnë me prindër .

1.7 Studentët që vijnë nga familjet e ngushta, që kanë më shumë se dy studentë .

2. Studentët e këtyre kategorive kanë bonusë shtesë, një (1) pikë më tepër, në aspektin e notës mesatare, notë mesatare që e përcakton kategorinë e studentit për bursë ,sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje si :

2.1 Studentët, persona me aftësi të kufizuar

## 2.2 Studentët fëmijë të dëshmorëve

### Neni 11 Dëshmitë për rastet sociale

Gjendja ekonomike financiare e familjes (prindërve apo kujdestarit) të nxënësit apo studentit, vërtetohet sipas dëshmisë që e lëshon Qendra për Punë Sociale në Obiliq. Komisioni për ndarjen e bursave e ruan të drejtën të hulumtojë dhe të vërtetojë gjendjen e vërtetë ekonomike dhe financiare të kandidatit.

### Neni 12 Ndarja e çmimit

Nga fondi i Kryetarit të Komunës, ndahen bursa, në emër të çmimit „Adem Preniqi” për studentët më të dalluar të vitit përkatës.

Bursat ndahen me rastin e 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit. Lartësia (shuma) e bursës do të jetë me koeficient, sa dyfishi i bursës së rregullt të vitit përkatës.

### Neni 13 Kushtet dhe kriteret për ndarjen e çmimit

1. Përfituesi i bursës për çmimin „Adem Preniqi”, do të zgjidhet nga aplikuesit për bursë të rregullt, në bazë të katër kriterëve:

- 1.1 Të jetë studentë, studente në vitin e fundit të studimeve.
  - 1.2 Të mos ketë të përseritur ndonjë vit gjatë studimeve.
  - 1.3 Të ketë eliminuar, përkatësisht përfunduar vitin paraprak për të cilin ndahet bursa.
  - 1.4 Të ketë notën mesatare, më të lartë gjatë studimeve (të të gjitha viteve paraprake) ndaj studentëve tjerë, por jo më pak se 9 (nëntë).
2. Bonusi (shtesa) në aspektin e notës mesatare, që është paraparë në nenin 10, të kësaj Rregulloreje, nuk vlen (nuk aplikohet), për çmimin „Adem Preniqi”.
3. Nëse nota mesatare e konkurrentit është e njëjtë, atëherë numri i provimeve të dhëna për vit të njëjtë të studimeve, do të merret në konsideratë si përparësi.

### Neni 14 Ndarja e çmimit sipas kriterëve të njëjta

Në qoftë se disa studentë ose studente i kanë kriteret e njëjta, sipas nenit 13, atëherë studenti që ka më tepër provime të dhëna ka përparësi, nëse edhe në këtë rast kriteret e plotësuar janë të njëjta atëherë, çmimi „Adem Preniqi” do të ndahet me short, kushtin e shortit do ta përcaktojë Kryetari i Komunës.



#### Neni 15

##### Ndarja e shpërblimeve

Komuna e Obiliqit, varësisht prej mjeteve në dispozicion, ndan shpërblime për nxënës nga komuna e Obiliqit, të cilët do të jenë fitues në Gara në nivel komune dhe republike , për tri vendet e para.

Komuna e Obiliqit, varësisht prej mjeteve në dispozicion ndan shpërblime për mësime ndërkombëtare apo udhëheqës të ekipit garues të nxënësve , sipas lëndëve apo lëmvive përkatëse, për të cilat nxënësit janë radhitur në tri vendet e para .

#### Neni 16

Kryetari i Komunës merr vendim për ndarjen e shpërblimeve dhe lartësinë e shpërblimit për secilin vend, sipas nenit 15 ,për nivelin komunal dhe republikan për nxënës ,dhe ndaras për mësime ndërkombëtare.

#### Neni 17

Shpërblimet ndahen pa përfunduar viti kalendarik përkatës , në të cilin janë mbajtur garat dhe janë zënë tri vendet e para

#### Neni 18

##### Kriteret për të fituar bursë për nxënës

1.Kriteret për të fituar bursën për nxënës janë:

- 1.1 Për nxënës të Gjimnazit "17 Shkurti" në Obiliq, të kenë të përfunduar klasën paraprake të shkollës së mesme me sukses të shkëlqyeshëm
- 1.2 Për nxënës të SHMLP "Isamil Dumoshi" në Obiliq, të kenë të përfunduar klasën paraprake, me sukses të shkëlqyeshëm ( bursa ndahet nga klasa e X-të).
- 1.3 Për nxënës, familjet e të cilëve janë raste sociale, në aspektin e gjendjes ekonomiko- financiare , të kenë të përfunduar klasën paraprake së paku me sukses të mirë ( bursa ndahet edhe për kl.e X-të)
- 1.4 Të jenë nxënës të rregullt dhe të vijnë në mësimin rregullisht, në shkollat e mesme të larta të Komunës së Obiliqit.

#### Neni.19

##### Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit

1.Komuna e Obiliqit do të bëjë kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në relacionin shtëpi –shkollë dhe anasjelltas, për nxënës të Komunës së Obiliqit, të cilët mësimet i vijnë në shkollat e komunës së Obiliqit (përfshirë drejtimet e shkollës së mesme, të cilat nuk janë në Komunën e Obiliqit), për këto kategori:

1.1 Nëse distanca e udhëtimit shtëpi–shkollë për nxënës, është së paku katër 3.5 km.

1.1 Për nxënës me nevoja të veçanta.

1.2 Për nxënës, familjet e të cilëve janë raste sociale, në aspektin e gjendjes ekonomiko- financiare ( në qoftë se në relacionet e udhëtimit të këtyre nxënësve është i organizuar udhëtimi publik apo privat).

#### Neni 20

##### Lartësia e kompensimeve të udhëtimeve

Kryetari i Komunës, në Këshillin e Drejtorëve merr vendim për shumën (lartësinë) e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në relacione të udhëtimit shtëpi - shkollë dhe anasjelltas, për secilën kategori të nxënësve veç e veç, sipas nenit 19.

#### Neni 21

##### Aktivitetet jashtëshkollore

Aktivitetet jashtëshkollore për nxënësia :

1. Shtetija njëditore, mbrëmja e semimaturës për nx. të kl. të 9-ta.
2. Ekskursioni , mbrëmja e maturës për maturantët.

Do të kompensohen, në qoftë se familjet (prindërit apo kujdestarët ) e tyre janë raste sociale në aspektin ekonomiko -financiar.

#### Neni 22

##### Lartësia e kopensimit të aktiviteteve jashtëshkollore

Kryetari i Komunës, në Këshillin e Drejtorëve merr vendim për shumën(lartësinë) e kompensimit të shpenzimeve të aktiviteteve jashtëshkollore, për secilin nivel të paraparë sipas nenit 21.

#### Neni 23

##### Vlerësimi i kushteve dhe kritereve

1.Pas skadimit të afatit për konkurim, komisioni do të bëjë shqyrtimin e kërkesave, dhe do të hartojë listën përfundimtare të kandidatëve përfitues të bursës gjegjësisht përfitues të kompenzimit të udhëtimit, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore .

2.Lista e përfituesve të bursës dhe përfituesve të kompensimit të udhëtimit do të shpallet publikisht, dhe do të vendoset në tabelën e shpalljeve të Komunës së Obiliqit, dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

#### Neni 24

##### E drejta e ankesës

Kundër vendimit të komisionit për ndarjen e bursave dhe kompensimit të udhëtimit, lejohet ankesë, në afat prej 5 ditësh nga dita e shpalljes, përkatësisht publikimit të listës së përfituesve të bursës, gjegjësisht përfituesve të kompensimit të

udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore, ankesa i drejtohet komisionit për ankesa, e cila brenda 5 ditësh nga përfundimi i afatit të ankesave do të shqyrtohet.

#### **Neni 25** **Lidhja e kontratave**

1. Me nxënës dhe studentë që e fitojnë bursën, dhe të drejtën e kompensimit të udhëtimit në relacionin shtëpi-shkollë lidhet kontratë .
2. Kontrata përpilohet nga DKA, e cila nënshkruhet nga përfituesi i bursës, Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Arsimit.
3. Nëse brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e njoftimit të kandidatit, përfituesi i bursës apo kompensimit të udhëtimit, nuk e nënshkruan kontratën, kjo do të konsiderohet se ka hequr dorë nga bursa apo kompensimi i udhëtimit.
4. Me kontratë do të përcaktohet kohëzgjatja e dhënies së bursës dhe kompensimit të udhëtimit.

#### **Neni 26** **Procedurat e pagesave**

1. Mjetet do të alokohen në xhirollogarinë e përfituesve të bursës, dhe përfituesve të shpenzimeve të udhëtimit, përfituesve të aktiviteteve jashtëshkollore, dhe përfituesve të Garave në nivel komunal dhe republike ( vendot e para , dyta dhe treta ) pranë ndonjë banke komerciale. ( në mungesë të llogarive të nxënësve mjete do të alokohen në llogari të prindërve apo kujdestarëve të nxënësve), ndërsa për fituesit e garave, pagesa bëhet pa përfunduar viti kalendarik përkatës.
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Drejtoria e Arsimit janë të obliguara që të përkujdesen për alokimin e mjeteve të përfituara për bursë në afatin sa më të shkurtër kohor.
3. Pagesa për bursë dhe kompensim të udhëtimit bëhet në dy pjesë, pjesa e parë në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor, dhe në semestrin e parë të vitit akademik, kurse pjesa e dytë do të bëhet në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor, dhe në semestrin e dytë të vitit akademik.

### **DISPOZITAT KALIMTARE - PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 27** **Zbatimi i Rregullorës**

Zbatimin e kësaj Rregulloreje nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës e bëjnë :Drejtoria për Arsimin dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.

**Neni 28**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Për Ndarjen e Bursave ,Kompensimin E Shpenzimeve Të Udhëtimit Dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore me nr.-I-53 e dt.03.04/2019.

**Neni 29**  
**Hyryja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së , si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb -faqen e Komunës .

**KUVENDI I KOMUNËS SË OBILIQIT**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Burim Gërguri**

nr. I-145 datë 30-04-2019

